



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2009

**V E N D I M**  
**Nr.1047, datë 17.11.2009**

**Për**

**“ Revokimin e Autorizimit Individual të sipërmarrësit “GEAM 1” sh.p.k. miratuar me VKD nr.845, datë 20.07.2009 “Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “GEAM 1” sh.p.k.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

Illir Shehu	Kryetar
Afrim Tonuzi	Anëtar
Edlira Kasaj	"
Illir Zela	"
Jetmir Karini	"

me sekretare Marsida Drushku, në datën 17.11.2009, në mbledhjen e rradhës të KD, sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim çështjen me objekt:

*“Propozim i Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës për revokimin e Autorizimit Individual të sipërmarrësit “GEAM 1” sh.p.k. miratuar me VKD nr.845, datë 20.07.2009 “Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “GEAM 1” sh.p.k.”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 1 dhe pika 2.d) e nenit 76 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 121 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Pika 1 dhe pika 2.g) e nenit 8 të Rregullores për Autorizimin Individual (**Rregullorja**), miratuar me VKD nr. 510, datë 04. 11. 2008;
4. Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP-it (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me VKD të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

## **KESHILLI DREJTUES,**

i njohur paraprakisht me dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Licensimit sipas praktikës shkresore të kesaj drejtorie, lidhur me çështjen dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

#### **Ana formale procedurale:**

1. Nga pikpamja formale procedurale, dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 10/1 të Rregullorës së Brendshme.

#### **II**

#### **Faktet:**

1. Sipërmarrësi "GEAM 1" sh.p.k. ka depozituar pranë AKEP kërkesën nr.1269 Prot., datë 04.03.2009, për caktim frekuencash sipas Rregullores, për sistem radiokomunikimi në brezin VHF, me zonë gjeografike qyteti Tirane.
2. KD i AKEP-it me Vendimin nr.845. datë 20.07.2009 ka miratuar kërkesën e sipërmarrësit "GEAM 1" sh.p.k. për dhënien e Autorizimit Individual, me kohëzgjatje 3 vjet.
3. Në vijim të procedurës, AKEP-i me shkresën nr.3174 Prot., datë 04.08.2009, ka njoftuar sipërmarrësin "GEAM 1" sh.p.k. për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe tërheqjen e Autorizimit Individual të miratuar, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Konfirmohet dorëzimi i këtij objekti postar tek sipërmarrësi "GEAM 1"sh.p.k më datën 05.08.2009.
4. Nga verifikimet e kryera rezulton se sipërmarrësi "GEAM 1" sh.p.k nuk ka bërë shlyerjen e detyrimeve financiare brenda afatit ligjor sipas pikës 2.d) të nenit 76 të ligjit nr. 9918. Gjithashtu nga përfaqësuesi i tij me shkresë nr.3550, dt.11.09.2009 është deklaruar se meqënëse në datën 01.06.2009 ka ndërprerë ushtrimin e aktivitetit nuk kërkon të pajiset me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave, pamvarsisht aplikimit që kishte depozituar më parë në AKEP.

### **PER KETO ARSYE;**

Duke qenë se moskryerja e pagesës nga ana e sipërmarrësit "GEAM 1" sh.p.k sipas përcaktimit të parashikuar në pikën 2d) të nenit 76 të ligjit nr. 9918 përbën shkak të bazuar ligjor për revokimin e plotë të Autorizimit Individual të këtij sipërmarrësi, miratuar me VKD të AKEP-it Nr. 845, datë 20.07.2009, si dhe kërkeses nr.3550, dt.11.09.2009 të sipërmarrësit për mos tërheqjen e Autorizimit Individual parashikuar në pikën 1, të nenit 76, të ligjit nr. 9918, KD i AKEP-it, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Të revokojë plotësisht Autorizimin Individual të sipërmarrësit "GEAM 1" sh.p.k, për përdorimin e frekuencave, miratuar me VKD Nr. 845 datë 20.07.2009.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Drejtorite e tjera te AKEP për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

---

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43  
253/1 Tiranë

Tel. ++ 355 4 2259 571  
Fax ++ 355 4 2259 106

[www.akep.gov.al](http://www.akep.gov.al)

Në përputhje me nenin 56 e vijues të ligjit nr. 8485, njoftohet/n pala/ët e interesuar/a lidhur me këtë vendim.

Vendimi është i apelueshëm në rrugë administrative dhe gjyqësore në përputhje me nenin 127 e vijues të ligjit nr. 8485.

**KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES**  
**Ilir SHEHU**

**Anëtarë të Këshillit Drejtues:**

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**

---

**Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43  
253/1 Tiranë**

**Tel. ++ 355 4 2259 571  
Fax ++ 355 4 2259 106**

**[www.akep.gov.al](http://www.akep.gov.al)**